
RECEPTIMI I CHARLES DIKENSIT - IT NË AUDITORËT E SOTSHËM TË UNIVERSITETIT THE RECEPTION OF CHARLES DICKENS IN TODAY'S UNIVERSITY AUDITORIUM

EVIS ÇELO

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri
eviscelo@yahoo.com

AKTET VI, 5: 500 - 504, 2013

PËRMBLEDHJE

Në artikull sipas sistemit të insertit shtrohet në diskutim çështja e procesit të mësimit të gjuhës së huaj, konkretisht të anglishtes duke pasur për ilustrim fragmente të një veprë letrare të një au-tori me famë botërore. Theksi kryesor vëhet mbi përkthimin e fjalëpërfjalshëm të shpre-h-je-ve të ngurosura: idiomave dhe proverbave nga anglishtja në shqip të përdorura në romanin Shpre-sa të mëdha të Çarls Dikensit. Përmes disa pikave orientuese në orën e mësimit stu-de-n-tët fitojnë njohuri si për atmosferën kohore shoqërore politike angleze të shekullit XIX dhe bi-o--grafinë e shkrimtarit, ashtu dhe për pritjen e romanit Shpresa të mëdha, si në kohën e bo-ti-mit, ashtu dhe në shekullin vijues. Vëmendjen kryesore në artikull e kemi përqendruar në hu-lu-m-ti-min e çështjeve të mëposhtme.

- (a) insert-i, si ndihmë në kuptimin e veprës Shpresa të mëdha dhe shprehjet idiomatike;
- (b) problematikat e hasura me studentët (nxënësit) dhe praktikat frutdhënëse;
- (c) mendime, debate nga studentët mbi mesazhin real të veprës dhe perspektivën;
- (d) Konkluzione.

Fjalët çelës: shoqëria, realiteti i shekullit XX, perspektivat, kulminacion, glorifikim.

SUMMARY

According to the insert system issue in the article is raised up the process of learning a foreign language, namely English having an illustration of literary fragments of one of the most world-famous author. The main emphasis on diagnosis is literally focused on the exp-re-ssions, idioms and proverbs from English to Albanian used in novel Great expec-tations of Charles Dickens. Through some orientation points in the class as students gain knowledge about social life of English political atmosphere in the nineteenth century and the biography of the writer, and for the reception of the novel Great expectations, as well as the time of pub-lication, and even in the following century. The main attention in the article we focused on the following research questions:

- (a) insert-i, as an aid in understanding of the work and the great hope idiomatic expressions;
- (b) problems encountered by students (pupils) and productive practices;
- (c) opinions, debates real message to students about the work and perspective;
- (d) Conclusions.

Key words: Life, the twentieth century, prospect, peak, glorification.

HYRJE

Për tu dhënë nxënësve informacion domosdosh-mërisht të përshtatshëm me interesat, nivelin dhe njëkohësisht me objektivat e mësuesit (pedagogut) përgjatë procesit mësimor është përshtatur metoda e INSERT-i. Kjo metodë është ekzaminuar me studentët e Universitetit "Ismail

Qemali", përkatësisht të Departamentit të Gjuhës Angleze.

Studentët njoftohen me realizmin kritik botëror të shekullit XIX dhe praninë e tij në veprën letrare të Çarls Dikensit. Duke folur për kohën kur u shfaq Dikens në letërsinë angleze faktojmë interesimin e madh të kritikës letrare të kohës

për vlerësimin e romanit *Shpresa të mëdha* në krye të realizimeve më të suksesshme në letërsinë angleze të kohës, për botën e tij përshkrimore dhe për gjuhën në të cilën është realizuar si fikcion artistik letrar. Pas kësaj hyrjeje kalohet në pjesën kryesore: në realizimin teknik e gjuhësor të veprës dhe sjelljen e tij me anë të përkthimit në gjuhën shqipe. Në këtë kontekst theksi vëhet mbi përkthimin fjalë për fjalë të shprehjeve idiomatike dhe të proverbave të përdorura në këtë roman. Qëllimi i artikullit është që lexuesit dhe studentët, përveç kuptueshmërisë së veprës, të gjejnë në të një dikotomi koherente, në mënyrë që të shfaqen dhe të veprojnë, jo vetëm si “konsumatorë” të veprës së Çarls Dikensit, por edhe si “prodhues real” në jetën e përditshme.

Inserti si ndihmë në kuptimin e shprehjeve idiomatike dhe proverbiale

Si çdo fjalë që ka një përdorim të caktuar, edhe fjala INSERT vjen prej gjuhës angleze dhe ka marrë një përdorim të gjerë, si në mediat e shkruara, ashtu edhe në mediat vizive. Sipas fjalorit të Pavli Qesku (Qesku 2000: 528-529) **1) Insert:** a) është fletë e shkruar; b) Fashikull i shtuar; c) pjesë reklame dhe informacioni shtesë, brenda një emisioni ose programi; **2) Inserti,** në rastin tonë, është akronim i fjalëve në anglisht (Interactive Noting System for Effective Reading and Thinking) që në shqip do të thotë: Sistem ndërveprues i shënimeve për të lexuarit dhe të menduarit e efektshëm.

Procedimi i tillë i orës mësimore është në funksion të interpretimit të përkthimit të veprës, gjetjes e nxjerrjes së mesazhit dhe praktikitetit individual të studentëve për të ndihmuar në rritjen e motivacionit për të mësuar e për të thithur dije. Në këtë drejtim do të merremi me rrahjen e këtyre çështjeve:

Në *çështjen e parë* flitet për kuptimin, origjinën, lidhshmërinë dhe përdorimin e INSERTit në mediat vizive dhe zbatimin e tij në procesin e mësimdhënies.

Në *çështjen e dytë* faktohet ana praktike e INSERT-it në duart e studentëve, me veprën

Shpresa të mëdha dhe me problematikat që dalin gjatë procesit mësimor.

Në *çështjen e tretë* i mësohet problematikës së veprës së Dikensit parë nga dy aspekte të dala nga prurjet e ballafaqimit të kontekstit: (a) të target-it ose të vizionit të pedagogut me (b) prurjet e realitetit praktik të sjella nga përvetësimi i lëndës nga nxënësit.

Strategjitë dhe teknikat që ndërtohen mbi shpresat e nxënësve për sukses, përfshijnë sigurinë dhe mundësinë reale për të mësuar të duhurën, duke marrë parasysh aftësitë e tyre të kuptimit të veprës, të përkthimit e të interpretimit dhe njëkohësisht të funksionit të idiomave dhe të proverbave për të dhënë mesazhin dhe idenë kryesore. E gjithë kjo ndërmarrje lidhet ngushtë me nivelin e mëparshëm të njohurive të studentëve të gjuhës angleze, si dhe të përcjelljes së vijës artistike e kuptimore të veprës.

“Një fjalë është shumë për të zgjuarin”

Midis veprave letrare të shkrimtarit të shquar anglez të shek të XIX, Çarls Dikens është edhe romani *Shpresa të mëdha*. Ky roman që në kohën kur u shfaq tërhoqi vëmendjen e lexuesit të thjeshtë e të mjaft kritikëve letrarë e estetë. Arsyet pse kemi vendosur të merremi me këtë roman janë të ndryshme, njëra prej më kryesoreve është për t’i zgjidhur e për të ecur më tej në perspektivat tona mësimore.

Mendimi kritik letrar anglez romanin *Shpresa të mëdha* e ka quajtur një nga “kulmet e fundit të krijimtarisë së Dikens-it”. Bastardhimi fizik e shpirtëror i aristokracisë së kohës, portretizohet me mjeshtëri në personazhin e Zonjës Havisham, e cila bëhet protagonistja kryesore e kësaj veprë letrare.

Njëkohësisht duke ditur edhe fëmijërinë e vështirë të autorit të ballafaquar me padrejtësitë më të egra të sistemit shoqëror, të sistemit anglez të shekullit të 19, është arsyeja më e fortë që kjo dramë vjen e tillë në duart tona. Kjo dramë është shumë e gjetur për ditët tona, për jetën tonë, ku vështirësitë ekonomike, shpirtërore dhe jetësore portretizohen më së miri.

Marrim si ilustrim një fragment të shkëputur nga romani *Shpresa të mëdha!*



“A word to the wise is enough”

I knocked at the door and I was told to enter. I found myself in a large room, where the curtains were closed to allow no daylight in, and the candles were lit. In the center of the room, sitting at the table was the strangest lady I have ever seen or shall ever see. She was wearing a wedding dress made of rich material and seem like it hasn't been smooth sailing for her. She had a bride's flower in her hair, were white but her hair: there were suitcase full of dresses and jewels around her, ready for a journey. She only had one white shoe on. Then I realized that over the years the white wedding dress had become yellow and the flowers in her hair had died and the bride inside the dress had grown old. Everything in the room was ancient and dying. The only brightness was her dark old eyes that stared at me. I began eating words.

In her voice she whispered eagerly “came in the light boy and remember “a word is enough”.

Etapat e leximit të tekstit

Fragmenti i mëlartëm i përket lëndës së letërsisë angleze. Sipas një leximi tradicional konstatojmë ze nxënësit këtë fragment nuk mund të arrijnë ta kuptojnë tërësisht. Përveç kësaj, nga ky fragment ata nuk e dijnë kuptimin e fjalëve të reja dhe informacionin, deri edhe çfarë dëshirojnë të dijnë më tepër. Organizimi i mëtejshëm i orës mësimore ndahet në disa etapa. Etapa e parë është *parapërgatitja e tekstit për lexim*, ndërkaq e dyta *leximi i tekstit* sipas insertit dhe e treta *sumimi i rezultateve*.

1. **Parapërgatitja** për leximin e tekstit kërkon të bëhen disa shenja, të cilat i përkasin INSERT-it. Këto janë:

“√ Tick” (kontrollo) nëse diçka e dini;

“-“ (minus) nëse diçka nuk e dini;

“+” (plus) nëse një pjesë e informacionit që ndeshet është i ri;

“?” (pikëpyetje) nëse informacioni është i paqartë ose dëshirohet të dihet diçka më shumë rreth tij.

2. **Pasi** përfundon leximi i fragmentit nxënësit pushojnë një moment për të reflektuar rreth asaj që kanë lexuar. Më pas kthehen nga shoku dhe shoqja që kanë në krah dhe diskutojnë për ato që kanë lexuar.

Disa nga pyetjet që mësuesi drejton janë:

- Në cilën kohë është shkruar pjesa, cilit stil i përket?

- Cilat janë njohuritë që studentët i kanë për Dikensin?

- Çfarë informacioni kanë marrë për atmosferën shoqërore angleze të shekullit XIX dhe a mund të kenë ngjashmëri me realitetin e sotëm?

- Çfarë indikojnë fjalët e nënvizuara me të zeza dhe si përkthehen?

- Si kuptohen idiomat dhe proverbat?

- Për cilën arsye autori e nis tekstin me të njëjtën frazë dhe, po ashtu e mbyll me të njëjtën frazë?

Shenjat mund të shërbejnë si një referencë e përshtatshme për të vërtetuar informacionin që pohon ose jo të njohurive të mëparshme të nxënësve. Ato po ashtu i referohen edhe informacionit të ri të paqartë, shprehjeve idiomatike dhe proverbove ose interesave dhe ideve të reja për të cilat dëshirojnë të mësojnë më shumë.

Është e vlefshme që të pajisim secilin pjesëmarrës (nxënës ose studentë) me një fletë në ndarje tabelore, si më poshtë.

3 - Nxënësit diskutojnë pjesën, mund t'i kthehen fragmentit duke e zgjeruar më tej edhe me ndonjë poster ose me projektor, i cili mund të përfundohet në shtëpi, por më parë duhet dhënë përgjigje në paqartësitë e nxënësit që reflektohen në tabelën e INSERTIT.

4 - Studenti duhet të japë një përkthim të përshtatshëm për tekstin dhe jo fjalë për fjalë të përkthejë shprehjet idiomatike. P.sh **a)** *began eating his words*; **b)** *one white shoe on*; **c)** *smooth sailing - ska qenë e shtruar me lule, ose eci / s'eci vaj fare (Jo s'ka qenë lundrim në ujëra të qeta)*.

5 - Studenti duhet të japë një përkthim të përshtatshëm për proverbin si hapës, ashtu dhe mbyllës të tekstit dhe mesazhin që ai përcjell. P.sh. -

“A word is enough for the wise” (Një fjalë është shumë për të mençurin) (jo për të zgjuarin një fjalë mjafton).

Kështu ora mësimore bëhet më e këndshme dhe informaconi përhapet me më efikasitet kur mësimi dhe mësimdhënia ka pjesën e argëtimit dhe të tolerancës.

✓ tick	+	-	?
<p>- koha e përdorur, e cila përdoret në stilin rrëfimtar në letërsi. <i>.- changed his mind (ndysho mendjen, sepse ka lidhje me shqipen)</i> <i>- in the public eye (në sy të publikut, sepse ka lidhje me shqipen)</i></p>	<p>- Charles Dickens është i njohur edhe si përkrahës i shtresës së varfër të shoqërisë. Zonja Havisham aristokratja e pasur e cila lëngon; por edhe shpreh hakmarrjen e saj ndaj botës së meshkujve.</p>	<p>Pse ajo mban të veshur vetëm një këpucë nusërie? (pyetja ka në përgjigjen e saj një shprehje idiomatike “smooth sailing” (Nuk e dinë nëse është idiomë apo proverb dhe përpiqen ta përkthejnë fjalë për fjalë)</p>	<p>- “A word is enough for the wise”(Një fjalë është shumë për të zgjuarin) (Pse teksti nis me këtë proverb dhe mbyllet me të?)</p>

Problematikat e hasura me studentët

Një nga fjalitë e mija të parapëlqyera në Kush-tetutën e Bavarisë ndodhet saktësisht në nenin 131 ku thuhet: *“Shkollat nuk duhet të trasetojnë vetëm njohuri dhe aftësi, por të formojnë zemër dhe karakter.”* (Musai, 2003: 219-220).

Duke qenë një ndër veprat e fundit të krijimtarisë së Dikensit, në të cilën veprojnë disa personazhe në një atmosferë të errët, të mjegullt e vetëshkatërruese, romani jep ikonën e Anglisë në shek e 19-të, e cila fragmentizohet nën petkun e Zonjës Havisham. Shkrimtari i madh na jep edhe portretin edhe fatin e personazheve të tjerë: Pipit, Meguicit, Havishamit dhe Estelës mbi të cilët rëndojnë dukuritë e shëmtuara të shoqërisë së kohës, gjë e cila është shumë e evidente për shoqërinë e sotme që gangrenizon dita ditës vlerat reale shoqërore.

Mania e Pipit, këtij të riu fshatar provincial për tu aristokratizuar, vihet përballë të arratisurit që e simbolizon Anglinë ‘burg “të madh”. Pipi është i pashkolluar e i paedukuar dhe i varfër. Po kështu janë edhe shokët e tij: për ta kjo është më se normale, por kur Pipit iu tha se kishte “shpresa të

mëdha” ai ndjeu pakënaqësi në vetvete dhe ishte i turpëruar prej vetes dhe të tjerëve. Për më tepër “shpresat e mëdha” apo perspektivat e mëdha janë një rrezik për jetën e tij, që, në realitetin e kiberbetikës kuptohet se pasiguria në jetë është më e madhe se një oportunitet, që do të thotë ose t’i hapë ose t’i mbyllë dyert e jetës.

Konkluzione

Metoda e mëlartme e INSERT-it ndihmon dhe thjeshton mënyrën e procedimit të orës së mësimi dhe ndihmon që nxënësit të testojnë dhe të eksplorojnë njohuritë e marra dhe ato që do t’i marrin për më tej.

Ndërkohë dhënia e tabelës që nxënësi të procedojë individualisht është pjesë e praktikitetit dhe e frymës së re bashkëkohore që edhe nxënësi të ndjejë që ka arritur diçka vetë, por më parë, e ritheksojmë sërish se, për të mbërritur deri këtu duhet t’i bindim ata se përse duhet të mësojnë diçka, përse u shërben!

Shembulli më i mirë për fëmijët në këtë rast do të ishin të rriturit e angazhuar, të cilët vazhdojnë të kualifikohen më tej, me interes dhe dëshirë dhe, për më tepër me një të ardhme jo vetëm të

projektuar me target, por edhe me të ardhmen alternative madje.

Bibliografia e përdorur

DICKENS, Charles (1861), *Great expectation*, London.

MUSAI, Bardhyl (2003), *Metodologjia e mësimdhënies*. Tiranë.

MUSAI, Bardhyl (2005), *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues*. Tiranë.

QESKU, Pavli (2000), *Fjalori anglisht - shqip*, Tiranë.

VON SCHNURBEIN, Barbara (2004), *Të mësosh me gëzim dhe sukses*. Tiranë..